

RIVAL 722 SL

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE

KLASA: 3



“KUJDES”



I RREZIKSHEM PER MJEDISIN. N.

Frazat e rrezikut: R43.

Frazat e sigurise: S2; S24, S37.

Lenda vepruese: 722 gr/lit *propamocarb hcl.*

Formulimi: *Koncentrat i tretshem (SL)*

Fungicid me veprim sistemik per mbrojtjen e kulturave perimore nga semundjet kepurdhore te rrenjeve, qafes dhe aparatit gjethor, te shkaktuara nga parasite te gjinive Pythium, Phytophthora, Pseudoperonospora, Bremia. Thithet kryesisht nga rrenjet dhe qarkullon me pas ne te gjitha sistemin mbitokesor te bimes. Perdoret gjithashtu me sukses edhe ne trajtimet gjethore.

Ka efekt stimulues ne zhvillimin e sistemit rrenjor dhe ate vegjetativ te bimeve te trajtuara ne fazat e para.

Masat parambrojtese:

- Ruajeni larg ushqimeve dhe pijeve per njerezit si dhe ushqimeve per blegtorine.
- Mbajeni ne vende te sigurta dhe te paarriteshme nga femijet.
- Evitoni kontaktet me syte dhe lekuren.
- Gjate perdorimit te tij mos ha dhe mos pi uje e duhan.
- Gjate punes perdor paisje mbrojtese: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Pas perfundimit te punes lani duart dhe pjeset e ekspozuara te trupit.
- Lani paisjet mbrojtese ne perfundim te punes.
- Beni shkaterrimin e ambalazhit sipas rregullave ne fuqi.

Keshilla per mjekun:

- Ne rast kontakti me lekuren apo syte, lani menjehere me uje te paster dhe sapun pjeset e kontaminuara.
- Ne rast gellitje ose marrje me organet e frymemarrjes, i aksidentuari vendoset ne nje vend me ajer te paster dhe te fresket dhe mbulohet per t'u mbajtur ngrohte. Me pas dergohet ne nje qender spitalore ku tregohet etiketa e produktit. Si ndihme e pare te aksidentuarit i behet lavazh i stomakut ose shplarja e lekures me sapun dhe solucion ujor te bikarbonatit te natriumit.
- Ne rast demtimesh te renda dergojeni te aksidentuarin ne qendren spitalore me te afert, duke i treguar mjekut etiketen.
- Propamocarb i perket grupit te karbamateve, prandaj i aksidentuari mund te trajtohet me atropine, te shoqeruar me mjekime te tjera sipas simptomave. Te aksidentuarit i behen injeksione endovenoze me atropine cdo 10 min deri sa te duken shenjat e atropinizimit. Ky mjekim mund te vazhdoje 24-48 ore.

Perdorimi:

- *Ne dizinfektimin e dherishteve:* Per nje m³ dherishte perdoret 300 ml preparat, i tretur me 20 lit uje.

- *Ne trajtimet ne farishte:* 8-12 ml preparat/m² shtrat, duke e shperndare me 4-5 lit uje; nje trajtim i dyte behet 5 dite para nxjerrjes se fidanave nga farishtja.

- *Pas mbjelljes:* kryhen trajtime me solucion 0.2 %, duke perdorur 100-200 ml solucion/bime e duke kryer 3-4 trajtime te perseritura cdo 10-15 dite.

Verejtje per perdorimin:

Perzihet me te gjitha fungicidet me perjashtim te atyre me reaksion alkaline si bordolezi, polisulfuri, etj.

Fitotoksiciteti:

Nuk shkakton toksicitet tek bimet nese perdoret sipas udhezimeve.

Karenca:

Nuk aplikohet

Ndikimi ne ekosistem:

Nuk jep ndikim ne mjedis kur perdoret sipas rekomandimeve te mesiperme.

Ruajtja dhe magazinimi:

Ruhet ne vende te thata, ne temperatura jo me te uleta se -10° C dhe jo me te larta se 40° C.

Nr dhe data e regjistrimit: 597, datë 06.07.2015;

Sasia neto: 200L

Data e prodhimit: **Janar 2017**

Periudha e ruajtjes: **3 vjet**

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: **Zenith CropSciences Bulgaria. Asenovgradsko Shose, 4009 Plovdiv, Bulgaria.**

Emri dhe adresa e Aplikantit: **Zenith CropSciences Bulgaria. Asenovgradsko Shose, 4009 Plovdiv, Bulgaria.**